



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 159**

**30 shtator**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

Akt normativ i KM  
nr. 5, datë 30.9.2013

Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin  
civil” .....

Faqe

7213

**AKT NORMATIV**  
**Nr. 5, datë 30.9.2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.152/2013, “PËR NËPUNËSIN CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, duke pasur në konsideratë parashikimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, pazbatueshmërinë e tij për shkak të mungesës së akteve nënligjore dhe natyrës së përgjithshme të ligjit, kohën e pamjaftueshme për të bërë rregullime ligjore sipas procesit legjislativ, nevojën për organizimin institucional, efektet financiare mbi buxhetin e shtetit dhe gjendjen ekonomike financiare, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe të Ministrisë të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 152/2013, datë 30.5.2013, “Për nëpunësin civil”, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Neni 70 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 70

Ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen nga data e fillimit të shtrirjes së efekteve të këtij ligji.”.

**Neni 2**

Neni 72 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 72

Ky ligj hyn në fuqi më 1 tetor 2013 dhe i fillon efektet e tij 6 muaj pas hyrjes në fuqi. Deri në datën e fillimit të efekteve të këtij ligji zbatohet ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil.”.

**Neni 3**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 30.9.2013  
Doli nga shtypi më 30.9.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 6 lekë